



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DURRËS
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Nr. 21, datë 06.03.2024

PËR NGRITJEN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT KËSHILLIMOR PËR SHQYRTIMIN E PROPOZIMEVE PËR DHËNIEN E TITUJVE VENDORË TË NDERIT PRANË BASHKISË DURRËS

Në mbështetje të Ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit nr. 94/2022, datë 22.12.2022 “Për titujt e nderit dhe titujt vendorë të nderit në Republikën e Shqipërisë”, Ligjit nr. 8480, datë 27.5.1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, Ligjit nr. 35/2023, “Për kompetencat për caktimin e pagave, trajtimeve të tjera financiare dhe përfitimeve të të punësuarve në institucionet e administratës publike, si dhe të pagës bazë minimale në shkallë vendi”, Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 195, datë 22.12.2023 “Për miratimin e programit buxhetor afatmesëm 2024-2026 dhe detajimin e buxhetit të Bashkisë Durrës për vitin 2024”, dhe sipas Relacionit të Drejtorisë së Arsimit, Kulturë, Rini, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI BASHKIAK
VENDOSI:



1. Miratimin e ngritjes dhe funksionimin e Komisionit Këshillimor për shqyrtimin e propozimeve për dhënie të titujve vendorë të nderit pranë Bashkisë Durrës.
2. Komisioni këshillimor përbëhet nga 5 (pesë) anëtarë, ku 3 (tre) anëtarë janë punonjës të institucionit të Bashkisë Durrës dhe 2 (dy) anëtarë janë personalitete të jashtme.

3. Miratimin e pagesës për çdo anëtar të Komisionit Këshillimor në shumën prej 6000 lekë (gjashtëmijë lekë) për çdo mbledhje.
4. Vendimi i Këshillit Bashkiak Durrës nr. 241, datë 14.01.2015 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Këshillimor për dhënien e titujve vendorë të nderit pranë Bashkisë Durrës”, shfuqizohet.
5. Ngarkohen Drejtoria e Arsimit, Kulturës, Rinisë, Sporteve dhe Komuniteteve Fetare, Drejtoria e Buxhetit dhe Drejtoria Ekonomike për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të nenit 55, pika 6, të Ligjit Nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar.

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Ani Dyrmishi



U shpall sot me datë 07.03.2024





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT DURRËS

Nr. 162 Prot.
7

Durrës, më 13.03.2024

Lënda: Verifikim i ligjshmërisë së aktit

**KËSHILLIT BASHKIAK
DURRËS**

**KRYETARIT TË BASHKISË
DURRËS**



Verifikova ligjshmërinë e Vendimit të Këshillit Bashkiak Durrës Nr.21 datë 06.03.2024 “Për ngritjen dhe funksionimin e Komisionit Këshillimor për Shqyrtimin e Propozimeve për Dhënie të Titujve Vendorë të Nderit pranë Bashkisë Durrës”.

E gjej atë të bazuar në ligj dhe në bazë të kompetencave që me jep Ligji Nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, e konfirmoj bazueshmërinë ligjore të tij.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin.

PREFEKTI

EMILJAN JANI

